
RECENSIONE

PËLLUMB XHUFI, “ÁRBËRIT E JONIT. VLORA, DELVINA E JANINA NË SHEKUJT XV–XVII”, KRISTALINA-KH, Tiranë 2016, 1440 f.

Në vazhden e punimeve të vyera të prof. dr. Pëllumb Xhufit mbi historinë mesjetare dhe moderne të shqiptarëve, shtohet edhe ky studim voluminoz i cili përmbush një boshllëk të konsiderueshëm për historiografinë shqiptare. Përmasat e këtij punimi i përshtaten më së miri historisë së pasur të këtij areali të rëndësishëm të Shqipërisë mesjetare dhe osmane. Monografia është e strukturuar në pesë pjesë të ndara në kapituj simbas një kriteri të gjetur kronologjiko-tematik që i përshtatet më së miri edhe tematikës së trajtuar përgjatë punimit.

Pjesa e parë “Shqipëria e Poshtme në Mesjetën e Vonë”, që i korrespondon pjesës së hyrjes përmban informacionet e duhura për nivelin e një punimi të tillë, ku autori që në kapitullin e parë na kumton edhe mënyrën e qasjes, e cila duke shfletuar faqet e punimit mund të thuhet se përbën një risi të nevojshme në traditën historiografike shqiptare. Punimi nis pikërisht me orientimin dhe përkufizimin hapësinor të objektit të studimit, me një përkufizim etnogjeografik të problemit. Boshti përreth të cilit sillet krej objekti i studimit është një element gjithmonë i pranishëm në historinë e lashtë shqiptare, por i neglizhuar në traditën historiografike, i munguari i madh i identitetit shqiptar: deti.

Është pikërisht deti Jon që e përkufizon edhe orientimin etnohapësinor të çështjes së trajtuar, është boshti që e mban dhe i jep kuptim etnogjeografik edhe Arbërive të Shqipërisë së Poshtme, ose më saktë Shqipërisë së Jonit. Këto Arbëri të Jonit shtrihen nga Vlora, në veri, deri në Gjirin e Prevezës, në jug, me një thellësi drejt lindjes, që pak a shumë kap pikat e Beratit, Gjirokastrës e Janinës. Këto *Árbëri* i bashkon e i ngjiz deti Jon, por, në një kuptim më të thellë, i bashkon historia e shek. XV-XVII. Pra, boshti hapësinor i punimit janë trevat e përfshira, tërësisht apo pjesërisht, në sanxhaqet e Vlorës, Delvinës e Janinës.

Ky studim voluminoz përbën një ndriçim thellësisht të detajuar dhe të dokumentuar të historisë politike, socioekonomike e kulturore të këtij areali gjeografik.

Qasja e ndryshme dhe shkencërisht më e argumentuar dhe më e saktë, vërehet që në tezën e parë të përcaktimit gjeografik të objektit të studimit, ku argumenton shterrueshëm logjikën e përdorimit të emërimit Arbëri - Shqipëri e Poshtme, në vend të emërimit anakronik Epir. Në këtë studim, veç aspekteve të historisë politike, ekonomike, sociale e kulturore, lexuesi do të konstatojë edhe një analizë në etnografinë e Epirit në shek. XV-XVIII, e cila ka munguar në studimet e deritashme për këtë trevë. Në mënyrë të detajuar këtu trajtohet struktura etnike e kësaj zone, e cila siç e pohon dhe e analizon me rigozitet e paanësi autori, ishte një hapësirë që pavarësisht faktit se elementi shqiptar përbënte shumicën, edhe elementë të tjerë etnikë si vllahët e grekët paraqiten si pjesë e rëndësishme e lëndës njerëzore të këtyre Arbërive historike dhe etnike. Një kontribut i rëndësishëm dhe i domosdoshëm është edhe trajtimi dhe kthjellimi i raporteve, nënshtetas osman-turk etnik, apo mysliman shqiptar-turk etnik. Autori depërton me siguri të plotë përtej terminologjisë jokoherente dhe anarkisë përfytyruese të vëzhguesve sipërfaqësorë, duke dhënë qartësisht përmes burimeve të vëzhguesve bashkëkohës dhe njohës të situatës, pamjen e një areali ku pavarësisht konfuzionit terminologjik, elementi etnik turk është inekzistent dhe kalimtar. Ky koncept bëhet akoma edhe më i argumentuar në faqet e vëllimit, ku në kapitujt pasardhës do të bëhet e qartë se jo vetëm etnikisht elementi turk ishte inekzistent, por edhe politikisht duke filluar që nga shek. XVI e duke iu afruar gjithnjë e më shumë cakut kohor të punimit, fundit të shek. XVII, rëndësia e pranisë së elementit turk-osman shkon duke u venitur edhe politikisht.

Kapitulli i dytë “Hyrje në historinë e qendrave kryesore të Shqipërisë së Poshtme”, është vazhdim logjik i kapitullit paraardhës, ku sërish qasja braudeliane depërton thellë në gjeografinë e zonës së trajtuar, duke shërbyer si një trajtim historik i nyjeve kryesore gjeografike që mbajnë të lidhur tërësinë e ngjarjeve dhe të dhënave historike të trajtuara në faqet e librit. Pa këtë kapitull, orientimi i lexuesit në ngjarjet dhe zhvillimet historike të kapitujve pasardhës të librit do të bëhej i vështirë, mbase i pamundur. Nyjet e kësaj tërësie janë me radhë Polina, Vlora, Dukati, Labëria, Kurveleshi, Himara, Porto Palermo, Sopot, Nivicë, Bubari, Saranda, Delvina, Butrinti, Vagenetia, Strobili, Bastia-Sajadha,

Igumenica, Janina, Margëlliçi, S. Nicolla, Nista e Arilla, Paksosi, Paramithia, Parga, Suli, Vilichi, Preveza. Secila prej këtyre pikave të rëndësishme të Arbërive të Jonit, në fakt mund të paraqitet si një traktat në vetvete i gjeografisë dhe demografisë historike të tyre. Gjithçka bëhet më e lehtë për t'u kuptuar pas këtyre dy kapitujve hyrës, që në fakt përbëjnë në vetvete një vlerë të shtuar në historiografinë shqiptare.

Pjesa e dytë "Turcus ante portas" i dedikohet procesit të vendosjes së sundimit osman në territorin në fjalë dhe nis me pasqyrimin e dokumentuar në hollësi të rënies së despotatit të Vlorës. Shqyrtimi i ekspeditës së Otrantos (1480), të udhëhequr nga Ahmed Gedik Pasha në të vërtetë përbën një pasqyrim të argumentuar gjerësisht të këtij episodi të rëndësishëm në vendosjen e ekuilibrave të rinj në arealin adriatikas. Pason përpjekja e një Gjon Kastriotit në Himarë, në kuadrin e kundërgoditjes shqiptaro-napoletane e vitit 1481 dhe Kundërmësymja osmane në sanxhakun e Vlorës. Fillimi i shek. XVI lajmërohet përmes Intervalit antiosman të Venedikut (1499-1503) dhe zbarkimit të një Skënderbeu të Ri në Shqipëri. Qëndrimi dhe sjellja e Skënderbeut të Ri, ndaj misionit të tij dhe bashkëpunimi e marrëdhëniet me administratorët shqiptarë të sundimit të sapovendosur osman, lajmëron që herët atë që do shkojë duke u bërë gjithnjë e më e dukshme në tre shekujt pasues: qasjen shqiptarocentrike të aktorëve shqiptarë pavarësisht fesë apo fuqisë politike të cilën përfaqësojnë.

Kapitulli i dytë, "Despotati i Shqiptarëve" sjell në detaje periudhën e sundimit të fisnikëve shqiptarë të Shpatajve dhe Zenebishëve, si zotër të Epirit dhe dinamikën e vendosjes së sundimit osman në zonat më jugore të shtrirjes gjeografike të punimit. Kapitulli pasues, gjithashtu është vazhdim logjik i studimit, mbasi trajton historinë dhe rëndësinë e pranisë së shqiptarëve në anën tjetër të Arbërisë së Jonit, në Korfuz. Në këtë punim Korfuzi paraqitet me të drejtë si një "Venedik" Jonian që qëndron përballë dhe afër Arbërive Joniane. Afërsia dhe rëndësia gjeografike e Korfuzit, së bashku me domethënien dhe rolin e tij historik si zotërim venedikas gjatë gjithë periudhës së trajtuar e bën më se të logjikshme dhe të domosdoshme edhe pasqyrimin e marrëdhënieve të shqiptarëve me të.

Pjesa e tretë "Pax ottomana", ka të bëjë me pasqyrimin e historisë së zonës gjatë sundimit osman, apo "pax ottomana". Vendosja e regjimit të pushtimit shtjellohet përmes përshkrimit të krijimit të sanxhaqeve të Shqipërisë së Poshtme, me vojvodët, eminët dhe të dërguarit e posaçëm të Portës. Këtu ilustron në mënyrë të dokumentuar procesi i shkallë-

shkallshëm i monopolizimit të pushtetit lokal nga shqiptarët dhe pasqyrohet protagonizmi i padiskutueshëm i shqiptarëve në trojet e tyre, si edhe përballja e përplasjet e tyre me të dërguarit e pushtetit qendror osman. Vijon analizimi në detaje i paqes së brishtë të venedikasve me turqit, si edhe i qasjes strategjike të Venedikut përmes diplomacisë e dhuratave dhe përshkimi i ekuilibrave të brishtë gjeopolitikë që lëkunden pa pushim mes luftës e paqes.

Në kapitullin “Shqipëria osmane ushqen Korfuzin Venecian” trajtohen aspekte ekonomike. Ai është i ndërtuar mbi një bazë të gjerë dokumentare dhe arrin të japë një panoramë të hollësishme të çështjeve që trajton. Autori shtjellon problematika rreth prodhimit dhe tregtisë, zanateve të ndryshme, monedhave dhe aspekteve të tjera kulturore. Çështjet e trajtuara shtjellojnë aspekte si : orientimi i tregjeve të drithit, rëndësia e Vlorës si qendër tregtare, monopoli venecian dhe rivaliteti me Raguzën. Prodhimi i drithit në sanxhakun e Delvinës e shndërron këtë zonë në një hambar për Korfuzin Venecian dhe medoemos kjo do të pasqyrohet në negociatat e ndërlikuara për të dhjetat e drithit dhe në rivalitetin tregtar për çmimet. Gama e prodhimeve që kjo zonë ofronte në tregun e huaj përfshinte një numër të rëndësishëm produktesh bujqësore dhe zejtare siç ishte prodhimi i kripës, peshkoret, valanidhi, sera, pyjet dhe tregtia e lëndës drusore, prodhimi dhe tregtia e sapunit, produkte të çmuara: mëndafshi dhe kallami i sheqerit. Të gjitha këto produkte përbënin bazën në të cilën mbështetej zhvillimi i panairëve tregtare me karakter lokal dhe ndërkrainor. Përveç kësaj tregtie natyrisht zhvillohej edhe tregti e ndaluar, kryesisht në mallra të konsideruara me karakter strategjik nga autoritetet përkatëse si edhe falsifikatorët e monedhave, të cilët ndiqeshin dhe ndëshkoheshin qoftë nga osmanët qoftë nga venedikasit.

Kjo pjesë përmbillet me pasqyrimin e dokumentuar gjerësisht të qëndresës ndaj regjimit osman dhe njëkohësisht përshkruan braktisjen që venecianët u bëjnë kryengritjeve shqiptare, për hir të miqësisë dhe tregtisë së patrazuar me osmanët, afrimin e opsionit spanjoll, dhe ndihmesën që i japin kryengritjes së Himarës (1596). Ilustrohet më së miri se shpirti kryengritës i shqiptarëve nuk njeh kufizime fetare apo krahinore dhe madje as sociale.

Një vend i veçantë i kushtohet rolit të kryengritjes së Shqipërisë së Poshtme të vitit 1611, ku shpalosen të dokumentuara projektet kryengritëse shqiptaro-spanjolle në Epirin shqiptar në fillim të shek.

XVII, që kulminojnë në sulmin mbi Janinë të udhëhequr nga Dionis Filozofi (shtator 1611), ashtu si edhe shkaqet e pasojat e kësaj kryengritjeje.

Në pjesën e katërt spikasin dy kapitujt, “Piratë e grabitës”, dhe “Agjentë e informatorë”, që sjellin imazhin e një Arbërie Joniane fluide që ndërvepron me aktorë e faktorë të afërt e të largët gjeografikisht, në një histori tipike që ilustron realitetin e Mesdheut të filleve të kohës së re.

Kjo vepër monumentale e historiografisë shqiptare përmbillet natyrshëm me trajtimin e aspekteve shoqërore e kulturore dhe me identifikimin e analizimin e dinamikave dhe dukurive konverguese e diverguese. Sillen përpara lexuesit të dhëna shumë interesante rreth aspekteve administrative, si dhe të dhëna mbi përbërjen e popullsisë, me detaje të shumta dhe analiza të hollësishme rreth marrëdhënieve të niveleve të ndryshme të pushtetit dhe të hierarkisë administrative. Në këtë pjesë bie në sy kapitulli i fundit, mbi fillet e nacionalizmit i cili në fakt sfidon në mënyrë shumë të argumentuar klishetë historiografike rreth nacionalizmit dhe zhvillimit të ndjenjës kombëtare ndër shqiptarë.

Pasqyra e burimeve të përdorura dhe bibliografia janë tejet të pasura. Është një ndihmesë e madhe edhe për studiuesit dhe studentët e historisë fakti që citimi i dokumenteve është bërë në mënyrë të zgjeruar dhe në origjinal gjë që e bën punimin në njëfarë mase edhe përmbledhje dokumentare.

Në përfundim, mendojmë se ky libër i prof. dr. Pëllumb Xhufit, është një pasurim i traditës së vyer të veprave historiografike që Instituti i Historisë ka dëshmuar vazhdimisht deri më sot. Punimi është një hap i rëndësishëm në historiografinë shqiptare mbasi konceptimi, qasja dhe realizimi i punimit përbën një përafrim me shkollat historiografike europiane bashkëkohore dhe një gërshetim mjeshtëror të tyre me traditën më të mirë të shkollës historiografike shqiptare. Përmes një qasjeje braudeliane, Arbëritë e Jonit dalin në këtë punim me plotësinë e tyre si pjesë kyçe jo vetëm të historisë së shqiptarëve por edhe të Mesdheut.

Pasuria dokumentare e sjellë në faqet e punimit, së bashku me analizat përkatëse hollësisht të detajuara dhe të strukturuar në tërësinë organike të punimit, krijon mundësinë për punime dhe analiza të mëtejshme, duke u mbështetur në informacionin e bollshëm të paraqitur, duke shërbyer si material bazë për analiza sasiore, të aspektit, ekonomik, demografik apo prosopografik nga studiues të interesuar.

Në një këndvështrim më të gjerë, rajonal ballkanik e mesdhetar, ky punim është një prezantim i shkëlqyer i historisë së kësaj zone gjeografike dhe në përgjithësi i historisë shqiptare në shek. XV-XVII, një këndvështrim që i ka munguar prezantimit të historisë shqiptare jashtë kufijve të ngushtë shqiptarë. Në këtë aspekt, botimi i këtij punimi voluminoz, thellësisht të dokumentuar dhe të realizuar mjeshtërisht, përbën një kontribut me vlerë që i tejkalon caqet e historiografisë shqiptare.

DR. ARDIAN MUHAJ

